



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
KOMISIONI I POSAÇËM

**KOMISIONI I POSAÇËM PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË
PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË PJESËMARRËSVE NË KAPITALIN E
OPERATORIT TË TREGUT**

Meqenëse:

- Me Vendimin nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatëkeqësisë natyrore” është shpallur gjendja e fatëkeqësisë natyrore,
- Në nivel ndërkombëtar, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shpallur gjendjen e pandemisë,
- Planet e masave të marra në Republikën e Shqipërisë, si edhe në shumë shtete, për ndalimin e përhapjes së koronavirusit COVID-19 kanë ndikuar në shumë sektorë të ekonomisë,
- Pjesëmarrja në procedurën e *përzgjedhjes së pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të tregut*, dikton se subjektet të cilët duan të aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentacion në drejtim të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara, dhe përgatitja e dokumentacionit në kuadër të pjesëmarrjes në procedurë krahas vullnetit të këtyre subjekteve përfshin bashkëveprimin e domosdoshëm me administratën shtetërore, gjyqësore ose subjekte të tjera juridike,
- Situata e krijuar përmban rrethana të cilat janë të pazakonta, të paparashikueshme dhe përtej kontrollit të subjekteve juridike publike dhe private duke krijuar vështirësi të pakapërcyeshme për përmbushjen e detyrimeve juridike të cilat nuk mund të ishin shmangur edhe sikur të ishte ushtruar gjithë kujdesi i duhur,
- Në referim të të dhënave zyrtare nga organet shtetërore përgjegjëse në nivel kombëtar dhe informacionit në nivel ndërkombëtar, një afat i pritshëm i përfundimit të masave parandaluese nuk është i mundur,
- Duke marrë në konsideratë blerjen e dokumentave të procedurës konkurruese prej disa pjesëmarrësve të cilët gjatë ditëve të fundit kanë shprehur zyrtarisht shqetësime në lidhje me vështirësitë e krijuara dhe pamundësinë për përgatitjen dhe dorëzimin e propozimeve të tyre dhe dokumentave shoqëruese;

Sa më sipër, në mbështetje të Dokumentave të Procedurës Konkurruese të Përzgjedhjes së Pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut, Kapitulli II “Udhëzime për Pjesëmarrësit në Procedurën Konkurruese të Përzgjedhjes së Pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut”, Seksioni 5, paragrafi “Të drejtat shtesë të Komisionit”, pika 5.11 /iv.; **Komisioni i Posacëm** në kushtet e masave strikte dhe kufizuese, *pezullon pa afat* procedurën e dorëzimit të dokumentave si dhe të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut duke filluar nga data 8 Prill 2020, **si masë proporcionale** në mbrojtje të interesit më të lartë publik.